

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,si gjykatë civile e shkallës së parë ,duke vendosur në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Burim Emërllahu ,kryetar i trupit gjykues ,dhe gjyqtarët porot Asllan Zariqi dhe Nazmi Behluli ,anëtarë të trupit gjykues ,në çështjen juridike të propozuesit [REDACTED] nga Ferizaji Rr [REDACTED] p.n dhe propozueses [REDACTED] nga Ferizaji,me vendqëndrim në [REDACTED] ,të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson avokatja [REDACTED] nga Ferizaji,baza juridike zgjidhja e martesës me shkurorëzim,pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë jo publik,me datë 19.03.2018 mori këtë:

AKT GJYKIM

I.ZGJIDHET ME SHKURORËZIM martesë e lidhur me datën 07.11.1978 në Zyrën e Gjendjes Civile në Ferizaj, e evidentuar me numër rendor 228 dhe numër të referencës 25/2013RM/25001, martesë kjo e lidhur në mes të propozuesit [REDACTED] ,i lindur më datë [REDACTED] në [REDACTED] dhe propozueses [REDACTED] ,e lindur më datë [REDACTED] në Fshatin [REDACTED]

II.Ky aktgjykim është i plotëfuqishëm nga data 19.03.2018.

A r s y e t i m

Propozuesi [REDACTED] dhe propozuesja [REDACTED] ,përmes të autorizueses së sajë avokates [REDACTED] nga Ferizaji i kanë propozuar gjykatës që ta zgjidh me shkurorëzim martesën e lidhur në mes të propozuesve ,me datë 07.11.1978,në Zyren e Gjendjes Civile në Ferizaj,me arsyetim se raportet Bashkëshortore në mes të propozuesve janë çrregulluar seriozishtë dhe nuk ka gjasa që të rivendoset bashkëjetesa ndërmjet propozuesve.Propozuesi jeton në Kosovë,kurse propozuesja jetonë në [REDACTED] ,kështu që martesë faktike në mes të propozuesve ka pushuar dhe si e tillë ka mbetur vetëm formalishtë.

Meqë është kërkuar zgjidhja e martesës me marrëveshjen e përbashkët të bashkëshortëve,gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ,pa u lëshuar në verifikimin e fakteve në të cilat mbështetet propozimi për shkurorëzim në këtë aktgjykim,bazuar në nenin 84 të LFK-së ,por gjykata vetëm ka bërë leçimin e certifikatën e martesës,të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Ferizaj, me datën 19.12.2017 ,me numër rendor 228 dhe numër të referencë 25/2013 RM/25001 ,nga e cila gjykata ka vërtetuar faktin se propozuesit kanë lidhur martesë me datën 07.11.1978 në Zyrën e Gjendjes civile në Ferizaj ,ku gjykata në rastin konkret ka vepruar në pajtim me nenin 68 paragrafi 4 ,kurse me dispozitën 69 paragrafi 2 është paraparë si shkak i shkurorëzimit edhe shkurorëzimin me marrëveshje të dyanshme.Nga këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë palët kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë,ky aktgjykim është i plotëfuqishëm nga data e marrjes 19.03.2018.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ C.nr.1130/17

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

Kryetari i trupit gjykues gjyqtari
Burim Emërllahu

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

Me
Dana 19 03 2018

